



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura III

Sesioni pranveror

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion
Mbledhja nr. 30/2010

Prishtinë, 22 07. 2010, në orën 15:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

**I mbledhjes së Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport
dhe Telekomunikacion**

Në mbledhje morën pjesë: Myzejene Selmani - kryetare, Ethem Çeku, Fatmir Rexhepi,
Mursel Haljilji, Sala Berisha – Shala, Zef Morina dhe Qamile Morina.

Munguan: Adem Salihaj, Adem Grabovci, Kaqusha Jashari dhe Mufëra Şinik.

Stafi mbështetës: Armend Ademaj, Besim Haliti, Muhamet Morina dhe Nuriye Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Myzejene Selmani, kryetare.

Në këtë mbledhje u propozua ky

R e n d d i t e

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të 19. 07. 2010;
3. Shqyrtimi i Propozimvendimit të Qeverisë për anëtarët e Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit – AKP, nr. 03/134 të datës 14. 07. 2010;
4. Të ndryshme.

Kryetarja konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të 19. 07. 2010

Procesverbali i mbledhjes së 19. 07. 2010 u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Propozimvendimit të Qeverisë për anëtarët e Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit – AKP, nr. 03/134 të datës 14. 07. 2010

Kryetarja – Si Komision Funksional këtë Propozimvendim të Qeverisë për anëtarët e Bordit të AKP-së e kemi marrë për shqyrtim pas kërkesës që ia kemi drejtuar Kryesisë së Kuvendit. Kjo është kompetencë e Komisionit Funksional për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion dhe është sjellë me vonesë për shqyrtim. Kërkoj ta shqyrtojmë dhe pastaj ta procedojmë për seancë plenare.

Fatmir Rexhepi – Tha se ky Propozimvendim i Qeverisë, që në fillim është dashur të vinte në Komision për shqyrtim. Kandidaturat që janë propozuar nga Qeveria janë në pajtim me ligjin, sa i përket mënyrës procedurale. Si Komisioni Funksional, me qenë se është në kompetencën tonë, duhet ta shqyrtojmë dhe ta procedojmë për Kryesinë e Kuvendit.

Ethem Çeku – Ne, si Komision Funksional, kandidaturat e propozuara duhet vetëm t'i procedojmë në seancën plenare pa ndonjë rekomandim, sepse vetëm nga ana procedurale i plotësojnë kushtet për të shkuar për shqyrtim në Kuvend. Nga ana profesionale kjo çështje është e rregulluar me ligj, por ta shohim sa i plotësojnë kushtet.

Qamile Morina – Kjo çështje, me procedurë të rregullt, është dashur të vinte në Komision me kohë dhe jo kaq shpejt. Duhet të ndërpriten praktikat që çështjet e rëndësishme për vendin, siç është Bordi i AKP-së, të shqyrtohen me nguti, kur dihet se kanë përgjegjësi të madhe për zhvillimin ekonomik të Kosovës.

Zef Morina – Është kompetencë e Qeverisë t'ia propozojë Kuvendit bordet për agjencitë e pavarura. Puna jonë, si Komision Funksional, është ta shqyrtojmë a i kanë plotësuar kushtet nga ana procedurale me ligj - në këtë rast Bordi i AKP-së. Kërkoj që Propozimvendimi të procedohet në Kuvend për shqyrtim dhe për miratim.

Pas debatit Komisioni me 4 (katër) vota Për dhe 3 (tri) Kundër e nxori këtë

Rekomandim

Kuvendi i Kosovës ta shqyrtojë për miratim Propozimvendimin e Qeverisë për emërimin

e kryesuesit dhe të anëtarëve të tjerë të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit – AKP-së, nr. 03/134 të datës 14 .07. 2010, si në vijim: Dino Asanaj - kryesues, Slllobodan Petrovič - anëtar; Haxhi Arifi - anëtar dhe Bahri Shabani - anëtar.

5. Të ndryshme

Çështje vijuese.

Mbledhja përfundoi në orën 15: 30

E përgatiti:

Njësia e mbështetjes së Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Myzejene Selmani